



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Address: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 23 mars 2010
Ref. Nr. AGJ 08/10

Aktvendim për palejueshmërinë

në

Rastin Nr. KI 73/09,

Mimoza Kusari-Lila

Vs.

Komisionit Qendror Zgjedhor

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese e përbërë prej:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar

Pas lëshimit të **Vendimit**, me datë 26 shkurt 2010, me të cilën Kërkesa për masë të përkohshme, e paraqitur nga Mimoza Kusari-Lila u hodh poshtë, Gjykata, ne mënyrë unanime ka miratuar Aktvendimin e mëposhtëm mbi Palejueshmërinë e Kërkesës për sa vijon

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Znj. Mimoza Kusari-Lila, e cila ishte kandidatë për Kryetare Komune në Gjakovë në zgjedhjet e Qeverisë Lokale, që u mbajtën në Kosovë më 15 nëntor 2009 duke përfaqësuar partinë politike, Aleanca Kosova e Re (AKR).

Pala Kundërshtare

2. Pala Kundërshtare është Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), siç është themeluar me Nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Objekti i Shqyrtimit

3. Me 10 dhjetor 2009, parashtruesi i Kërkesës, Mimoza Kusari-Lila, paraqiti një Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në të cilën kërkon:
 - a) Vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Vendimit të KQZ-së, për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve lokale, të cilat u mbajtën më 15 nëntor 2009, pa konsideruar rezultatet e të gjitha ankesave dhe parashtrësive që janë paraqitur.
 - b) Lejimin e Masave të Përkohshme, me qëllim që rezultati i zgjedhjeve në Komunën e Gjakovës të anulohet në vendvotimet në të cilat procesi i zgjedhjeve është shkelur dhe urdhërimi i zgjedhjeve të reja nën mbikëqyrjen e KQZ-së.

Faktet

4. Pas zgjedhjeve lokale në Kosovë, që u mbajtën më 15 nëntor 2009, AKR, jo Znj. Mimoza Kusari – Lila, dorëzoi një numër ankesash në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në të cilat shprehej shqetësimi për parregullsi të vëna re gjatë zgjedhjeve. Megjithatë, KZAP-i refuzoi këto ankesa, pas shqyrtimit të tyre. AKR apeloi dy prej vendimeve të KZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë këto ankesa në Aktgjykimet e datës 4 dhjetor 2009, A.no.929/2009 and A.no.931/2009.
5. AKR, përsëri dhe jo Znj. Mimoza Kusari-Lila, paraqiti dhe një apel tjetër në Gjykatën Supreme të Kosovës, baza e së cilës ishte se KQZ-a shpalli rezultatet e zgjedhjeve lokale përpara se të ishin kryer të gjitha procedurat, të cilat, sipas pohimit të AKR, kanë shkelur Nenin 106.1 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë këtë apel më 4 dhjetor 2009, A.no.930/2009.

Bazat juridike

6. Neni 113. 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Përmbledhje e Procedurës në Gjykatë

7. Me 10 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, në emër dhe pwr dobi të saj.
8. Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtarin Ivan Çukaloviq si Gjyqtarin Raportues. Gjithashtu u formua dhe Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga Gjyqtarja Snezhana Botusharova, si kryesues, Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
9. Bazuar në raportin paraprak të Gjyqtarit Raportues, Ivan Çukaloviq, Kolegji Shqyrtues dhe Gjykata e plotë rekomandoi dhe pranoi që të mbahej një seancë dëgjimore me qëllim që të bëhej përcaktimi i fakteve lidhur me lëndën, të mundësonte shprehjen e palëve dhe të përcaktohej nëse kishte elementë që justifikonin vendosjen e masës së përkohshme, siç kërkohet nga parashtruesi i kërkesës.
10. Seanca dëgjimore u mbajt me 9 shkurt 2010 në Fakultetin e Drejtësisë, Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës u paraqit vetëm (e vet-përfaqësuar) dhe Znj. Nesrin Lushta u paraqit si Kryetare e KQZ-së.
11. Gjykata, pas procesit të këshillimit me 26 shkurt 2010, vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit të Kërkesës si të palejueshme.

Përmbledhje e Seancës Dëgjimore me 9 shkurt 2010

12. Parashtruesi i kërkesës tregoi se pas një numri total prej 15 ankesash nga partia e saj, AKR, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) anuloi rezultatet nga 15 vend votime, duke përfshirë 8 në Komunën e Gjakovës. Ajo theksoi se deri me datën 4 dhjetor 2009, data në të cilën u bë shpallja përfundimtare nga KQZ-a, Gjykata Supreme nuk kishte nxjerrë vendimet që u paraqitën nga partia e saj.
13. Znj. Nesrin Lushta, përfaqësuese e KQZ-së, theksoi se KQZ, në çdo moment ka vepruar gjithmonë brenda ligjit, duke u siguruar se të gjitha ankesat/prendimet kundër procesit të zgjedhjes dhe numërimit të ish-in përfunduar përpara shpalljes përfundimtare të rezultateve të zgjedhjes dhe numërimit. Ajo deklaroi se KQZ mbështetej në mënyrë specifike në Nenin 106 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme (i cili aplikohet, kur duhet, edhe në Zgjedhjet Lokale), i cili siguron se "KQZ do të shpallë rezultatet e zgjedhjes pas përfundimit të vendvotimeve dhe procedurave të numërimit dhe kur të gjitha ankesat e pazgjidhura që kanë të bëjnë me votimet dhe numërimet të jenë shqyrtuar nga KZAP dhe Gjykata Kushtetuese".
14. Kur u pyet gjatë seancës se nëse kishte dorëzuar ndonjë ankesë/parashtrës w dhe firmosur atë në KZAP ose Gjykatën Supreme, ajo u përgjigj se personi i cili kishte firmosur ankesat në KZAP në emër të saj, kishte vepruar sipas autorizimit të saj dhe se ajo ishte koordinatorja për ekipin/zyrën e zgjedhjeve për candidate për Kryetar Komune në Komunën e Gjakovës.

15. Ajo u pyet se cila ishte arsyeja që ky person, që kishte vepruar në emër të saj në KZAP dhe Gjykatën Supreme, nuk kishte firmosur Kërkesën paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në emër të saj. Ajo u përgjigj se ky person, në emër të saj dhe me pëlqimin e saj, kishte firmosur dhe paraqitur dokumentet në KZAP, si Kryetar i Grupit Zgjedhor me qëndrim në Gjakovë. Lidhur me Apelin në Gjykatën Supreme, ata e kishin përgatitur bashkë dhe e kishin firmosur atë. Lidhur me Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, ajo theksoi se ajo ka qenë përgjegjëse për të gjithë procesin e apeleve, dhe prandaj e kishte firmosur kërkesën e Gjykatës Kushtetuese.
16. Në përfundim, parashtuesi i Kërkesës pranoi se është e saktë se ajo nuk kishte firmosur asnjë ankesë ose apel në KZAP ose Gjykatën Supreme. Megjithatë ajo përforcoi se çdo gjë është bërë me pëlqimin e saj, pasi ajo kishte marrë pjesë në biseda dhe takime me dëshmitarë dhe njerëz të cilët sillnin dokumente dhe informacione për parregullsitë gjatë ditës së zgjedhjes.
17. Në përgjigjen e saj lidhur me dispozitat precize ligjore të Kushtetutës, në të cilën ajo mbështet pretendimin e saj, ajo tha se mbështetej në Nenin 45 [Liria Zgjedhore dhe Pjesëmarrja], si dhe Nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].
18. Në vijim, kur u pyet se në çfarë mënyre është shkelur e drejta e saj kushtetuese për t'u zgjedhur, ajo konsideroi se liria zgjedhore dhe pjesëmarrja ishin shkelur. Sipas Nenit 45, e drejta e saj për t'u zgjedhur është mohuar për shkak të mënyrës së interpretimit të Vendimeve nga KZAP.
19. Procesverbali i takimit të KQZ-së i datës 4 dhjetor 2009, paraqitur nga Znj. Lushta gjatë Seancës Dëgjimore, tregoi se Komisioni ishte në dijeni se kishte Apele ende të pazgjidhura. Në të vërtetë, KQZ-ja i kishte shtyrë vendimet e saj për disa orë duke pritur informacion nga Gjykata Supreme lidhur me këto apele. Më parë, me 1 dhjetor 2009, KQZ i kishte shkruar Gjykatës Kushtetuese duke pyetur nëse ka ndonjë rast ende të pazgjidhur në Gjykatë lidhur me zgjedhjet, dhe me një letër të së njëjtës datë, Gjykata u përgjigj duke i informuar se nuk ka asnjë rast në këtë Gjykatë. Znj. Lushta nuk adresoi Nenin 118.4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili siguron se apeli mund të qëndrojë në Gjykatën Supreme nga vendimet e KZAP-it në rrethana të caktuara.

Zgjedhjet

20. Neni 45 i Kushtetutës së Kosovës siguron:

Neni 45 [Liria zgjedhore dhe pjesëmarrja]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

21. Sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokolleve të saj janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ato përbejnë pjesën e së Drejtës Kombëtare. Neni 3 i Protokollit të Parë siguron të drejtën për zgjedhje të lira. Siguron se zgjedhje të lira do të mbahen "...me intervale të arsyeshme me votim të fshehtë, në kushte të cilat do të sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve..."
22. Neni 123.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron se ' Vetëqeverisja Lokale ushtrohet nga organe përfaqësuese që zgjidhen me anë të zgjedhjeve të përgjithshme, të lira, të barabarta, direkt dhe të fshehta'. Kuvendi i Kosovës ka siguruar një mekanizëm për mbajtjen e Zgjedhjeve të Përgjithshme dhe Lokale duke miratuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës dhe Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-040.
23. Natyra e të drejtave për të votuar në zgjedhje dhe për të kandiduar në zgjedhje dallohen në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjykata ka theksuar se e drejta për të votuar është e drejtë aktive dhe e drejta për tu zgjedhur është e drejtë pasive. Parashtruesi i kërkesës mban qëndrimin se e drejta e saj për tu zgjedhur është shkelur. Megjithatë, ka një ndryshim midis të drejtës për tu zgjedhur dhe të drejtës për të kandiduar në zgjedhje. Jurisprudenca e GJEDNJ tregon se ekziston një liri veprimi e konsiderueshme që Shtetet kanë në sistemin e tyre elektoral dhe ata lejojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi lidhur me mënyrën që janë zhvilluar zgjedhjet dhe se si shpallen rezultatet e zgjedhjeve. Në rastin e Partisë Komuniste të Bashkuar të Turqisë vs Turqia, Gjykata theksoi se '(Shtetet) kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë sferë, por është Gjykata, si mundësia e fundit, e cila vendosë nëse kërkesat e Protokollit të Parë janë pajtuar; ajo kënaqet kur kushtet e vëna nga Shtetet nuk zvogëlojnë të drejtat në fjalë dhe deri diku nuk dëmtojnë thelbin e tyre ashtu që t'i privojnë këto të drejta nga efektiviteti i tyre; kur ato kërkesa e kushte të vëna nga Shtetet imponohen në ndjekje të një qëllimi legjitim ; kur mjetet që përdoren nuk janë në disproporcion (shihni Sadek and Others (no.2) vs Turkey, no.25144/94 et al, 31, ECHR 2002-IV).
24. GJEDNJ ka shprehur vazhdimisht rëndësinë e zgjedhjeve të lira dhe të demokracisë në Aktgjykimet e saj. Në të njëjtin Aktgjykim, Gjykata shprehu mendimin e saj për si vijon: 'Demokracia paraqitet si modeli i vetëm politik i parashikuar nga Konventa dhe , për pasoje, i vetmi që pajtohet me të'. GJEDNJ, në të njëjtin Aktgjykim citoi me miratim Kodin e Praktikës së Mirë, i aprovuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në seancat e 51(Udhëzimet) dhe 52 (Raporti) me 5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002 (Opinion nr. 190/2002, CDL-AD(2002) 23 rev). Komisioni i Venecias me këtë rast deklaroi:

Pesë parimet mbi të cilat mbështetet trashëgimia zgjedhore e Evropës janë se zgjedhjet duhet të jene : universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe përmes një votimi të drejtpërdrejt. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të mbahen në intervale të rregullta.

25. Komisioni i Venecias vë në dukje se organizimi i zgjedhjeve duhet të mbikëqyret nga një organ i pavarur, përgjegjës për aplikimin e ligjit zgjedhor dhe që të ketë një sistem efektiv apeli. Sipas ligjit në Kosovë, këto dy funksione kryhen respektivisht nga KQZ-ja dhe KZAP-i, me të drejtën për ankesë/apel në gjykatë në rastet e parashikuara nga ligji. Vetëm këto dy janë organet të cilat vendosin me të gjitha çështjet lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve, certifikimit të rezultateve dhe kush gjykon mbi ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, siç parashihen me ligj dhe rregullat zgjedhore. Këto janë organe të përhershme e të pavarura.
26. Arsyetimi që KQZ dhe KZAP-i kanë këto autorizime dhe tagra mbështetet në supozimin se duhet të ketë siguri në procesin e zgjedhjeve. Nevoja e sigurisë në procesin zgjedhor kërkon anulimin e zgjedhjeve vetëm në rastet e shkeljeve më serioze dhe barra e vështire e të provuarit bie me këdo që pretendon për kësi lloj shkeljesh.
27. Roli i Gjykatës Kushtetuese në procesin zgjedhor njihet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku në Nenin 106.1 thuhet se KQZ do të certifikojë rezultatet e zgjedhjeve vetëm pasi KZAP dhe Gjykata Kushtetuese të kenë shqyrtuar ankesat e paraqitura. Kjo Gjykatë nuk ka rol tjetër në proceset zgjedhore dhe nuk mund të rishqyrtojë ose rishikojë vendimet e KQZ-së dhe KZAP-it, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur ka ndodhur shkelje e të drejtave dhe lirive individuale të cilat garantojnë me Kushtetutë

Vlerësimi i Lejueshmërisë së Kërkesës

28. Me qëllim të vendosjes mbi Kërkesën e Parashtruesit, fillimisht Gjykata ekzaminon nëse Parashtruesi ka plotësuar kriteret e lejueshmërisë siç parashihen në Kushtetutë. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë se: "individët janë të autorizuar të paraqesin shkeljet nga autoritetet publike të drejtave të tyre individuale dhe lirive siç garantojnë me Kushtetutë, por vetëm pasi kanë shterur të gjitha mjetet juridike që sigurohen me ligj".
29. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit është t'iu lejojë autoriteteve në fjalë, përfshirë gjykatat, mundësinë e parandalimit ose me qëllim që të vendosë drejt mbi shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se kuadri ligjor i Kosovës siguron një mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (shih, *mutatis mutandis*, ECHR, Selmouni v. France, no.25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në këto procedura. Deri sa çështja është cekur në mënyrë implicite ose në substancë, shterimi i mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, ECHR, Azinas v. Cyprus, no.56679/00, vendimi i 28 prillit 2004).

30. Gjykata përdori të njëjtin arsyetim kur lëshoi Vendimin më datë 27 janar 2010 mbi palejueshmërinë për shkak të joshterimit të mjeteve juridike në rastin e Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K, Prishtinë vs Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/09.
31. Duke marrë parasysh Nenin 113.7 të Kushtetutës, Gjykata i shikon me kujdes hapat e ndërmarrë nga AKR dhe Parashtruesi i Kërkesës lidhur me apelet e dorëzuara, dhe në veçanti, nga cilët është dorëzuar. Pasi e kemi dëgjuar Parashtruesen e Kërkesës në Seancën Dëgjimore dhe duke pasur mundësinë për të ekzaminuar dokumentet e apeleve që u paraqitën gjatë evidencës, këto janë faktet e qarta që vijojnë.
32. Siç ishte e qartë nga evidenca dhe nga seanca dëgjimore, partia politike AKR ka dorëzuar apelet në KZAP dhe Gjykatën Supreme, dhe jo parashtruesi i Kërkesës. Hera e parë që përmendet emri i Parashtruesit të Kërkesës në dokumentacion, është në Kërkesën paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, i cili është pranuar nga kjo Gjykatë me 10 dhjetor 2009. AKR nuk ka paraqitur asnjë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese.
33. Partitë politike, si organizata të qytetarëve, kanë njohje të veçanta në procesin demokratik si një element i rëndësishëm i një shoqërie të shëndetshme qytetare (shih, *mutatis mutandis*, Gorzelik v Poland, 2004 GJEDNJ, Grand Chamber, para 93). Kjo Gjykatë ka thënë se liria e shprehjes së opinionit në zgjidhjen e legjislaturës është e paimagjinueshme pa pjesëmarrjen e pluralizmit të partive politike që përfaqësojnë opinione të nuancave të ndryshme, që gjenden në popullin e një shteti. Duke përcjellë këtë lloj opinionit, partitë politike japin një kontribut të pazëvendësueshëm drejt debatit politik, i cili gjendet në themelin e konceptit të një shoqërie demokratike (shih United Communist Party of Turkey v Turkey, 1998, GJEDNJ, Grand Chamber, para 89).
34. Parimet themelore, të përcaktuara në Ligjin Për Zgjedhjet e Përgjithshme, gjithashtu i japin rëndësi të veçantë partive politike, duke njohur se ato gëzojnë të drejtën për të bërë fushatë dhe se kanë të drejtën për barazinë e mundësive të kohës në radio dhe televizion, fondet publike dhe mbështetje tjetër.
35. Parashtruesi i Kërkesës ka qenë gjatë gjithë kohës anëtare e partisë politike, që i gëzoi këto të drejta dhe që përdori procedurën e apelit që ishte e disponueshme. Parashtruesi i Kërkesës ishte e lirë që të ndiqte këto apele në emër të saj, nëse dëshironte. Megjithatë, ajo nuk veproi kështu.
36. Neni 119 i Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme lejon secilin person, i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të KZAP-it të paraqesë ankesë në KZAP. Në këtë rast, faktet tregojnë se ajo nuk e ka bërë këtë ankesë. Prandaj, ajo nuk ka shterur të gjitha mjetet juridike që parashihen me ligj. Një nga kriteret që ajo duhet të plotësojë për të sfiduar kushtetutshmërinë e vendimeve që ajo dëshiron të referojë në Gjykatën Kushtetuese, është shterimi i të gjitha mjeteve juridike.

Konkluzion

37. Gjykata, pasi dëgjoji palët në seancën dëgjimore publike me 9 shkurt 2010, dhe pasi konsideroi të gjitha faktet dhe provat e paraqitura, si dhe pas procesit të këshillimit lidhur me këtë rast me 19 shkurt 2010

VENDOS UNANIMISHT

- I. Të HEDHË POSHTË Kërkesën si të palejueshme.
- II. Ky Vendim do t'ju njoftohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtueshmëri me Nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Përpiluar në Prishtinë

mars 2010

Gjyqtari Raportues.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

Prof. Dr. Ivan Čukalović

Prof. Dr. Enver Hasani

